Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0795
Data e Vendimit: 02.11.2023

Në bazë të nenit 105 pika 1 dhe 2, të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-092, pas shqyrtimit të ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) "DataProgNet" SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit "Mirëmbajtja dhe Përditësimi i Sistemit të Menaxhimit dhe Arkivimit Elektronik të Dokumenteve (SMAED)" me numër të prokurimit 214-23-7918-2-1-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME, Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit Vjosa Gradinaj Mexhuani me 02/11/2023, mori këtë:

Vendim

Hedhet si e palejuar, ankesa e OE "DataProgNet" SH.P.K. me nr. të protokollit 2023/0795, e datës 14/10/2023, ankesë kjo e parashtruar për aktivitetin e prokurimit "Mirëmbajtja dhe Përditësimi i Sistemit të Menaxhimit dhe Arkivimit Elektronik të Dokumenteve (SMAED)", me numër të prokurimit 214-23-7918-2-1-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Ministria e Punëve të Brendshme.

I lejohet, autoritetit kontraktues – Ministria e Punëve të Brendshme që të vazhdojë më tutje me aktivitetin e prokurimit "Mirëmbajtja dhe Përditësimi i Sistemit të Menaxhimit dhe Arkivimit Elektronik të Dokumenteve (SMAED)", me numër të prokurimit 214-23-7918-2-1-1, përkitazi me këtë ankesë, nëse nuk ka ndonjë ankesë tjetër për këtë aktivitet të prokurimit.

Në përputhje me nenin 31 pika 4, të Rregullores së Punës së OSHP-së, operatorit ekonomik ankues i kthehet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

-Faktet dhe rrethanat procedurale-

Organi Shqyrtues i Prokurimit në sistemin elektronik me datë 14.10.2023 ka pranuar ankesën me nr. 795/23 nga OE "DataProgNet" SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Mirëmbajtja dhe Përditësimi i Sistemit të Menaxhimit dhe Arkivimit Elektronik të Dokumenteve (SMAED)" me numër të prokurimit 214-23-7918-2-1-1, iniciuar Ministria e Punëve të Brendshme në cilësinë e Autoriteti Kontraktues.

Me datën 04.10.2023, Ministria e Punëve të Brendshme në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin e AK.

Me datë 09.10.2023 OE "DataProgNet" SH.P.K. në ora 23:43 kishte bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK-së. Ndërsa me datë 11.10.2023 AK ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim të operatorit ekonomik si të jashtafatshme.

- Administrimi dhe Vlerësimi i provave –

Nga provat e prezantuara vërtetohet se për aktivitetin e prokurimit "Mirëmbajtja dhe Përditësimi i Sistemit të Menaxhimit dhe Arkivimit Elektronik të Dokumenteve (SMAED)" me numër të prokurimit 214-23-7918-2-1-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK)–Ministria e Punëve të Brendshme, njoftimi i AK është publikuar në sistemin e-prokurimi me datë 04.10.2023. Ndërsa me datë 09.10.2023 në ora 23:43 OE "DataProgNet" SH.P.K. kishte bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK-së. Autoriteti Kontraktues me datën 11.10.2023 ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim të operatorit ekonomik si të jashtafatshme.

OE ankues ka qenë i obliguar që në pajtim me paragrafin 3.2 të nenit 108/A të LPP-së, brenda afateve ligjore të parashtroj kërkesë për rishqyrtim në AK dhe vetëm pas udhëheqjes së procedurave paraprake në AK, Operatori ekonomik në pajtim me nenin 109 të LPP-së do të mund ti drejtohet me ankesë OSHP-së. Neni 108/A paragrafi 3.2 i LPP-së përcakton se operatori ekonomik ankues kërkesën për shqyrtim duhet të dorëzoj tek autoriteti përkatës kontraktues: *në qoftë se shkelja e supozuar ka të bëjë me vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit, brenda afatit prej pesë (5) ditëve pas datës së njoftimit për dhënien e kontratës ose njoftimit mbi rezultatet e konkursit të projektimit që i është dërguar ankuesit.*

Po ashtu, edhe neni 60.1 pika b) në Rregulloren 001/2022 për Prokurim Publik përcakton se: *Kurdo që kërkesa për rishqyrtim ka të bëjë me vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit brenda afatit prej pesë (5) ditëve pas datës së publikimit të njoftimit mbi vendimin e AK (B58) ose njoftimit mbi rezultatet e konkursit të projektimit në sistem të prokurimit elektronik. Në kalkulim të afateve kohore, dita e publikimit të Njoftimit mbi vendimit të AK (B58) është dita (0).* Si dhe paragrafi 1 neni 5 i LPP-së përcakton se:*Afatet kohore të këtij ligji duhet të fillojnë në një ditë pune dhe të përfundojnë në një ditë pune. Afati kohor i shkon deri në 16:00 në ditën e skadimit. Autoriteti kontraktues mund të vendosë që të caktojë një kohë*

tjetër me kusht që ai është jo më herët se në ora 12:00 të ditës së skadimit.

Konstatohet se ankesa e parashtruar në Organin Shqyrtues të Prokurimit me datë 14.10.2023 nga OE "DataProgNet" SH.P.K., për aktivitetin e prokurimit me titull: "Mirëmbajtja dhe Përditësimi i Sistemit të Menaxhimit dhe Arkivimit Elektronik të Dokumenteve (SMAED)" me numër të prokurimit 214-23-7918-2-1-1, inicuar nga AK Ministria e Punëve të Brendshme, hedhet si e pa lejuar sepse ankuesi nuk ka parashtruar kërkesën për rishqyrtim brenda afateve ligjore kundër njoftimit të Autoritetit Kontraktues. Andaj Organi Shqyrtues i Prokurimit sqaron se vetëm pas udhëheqjes së një procedure paraprake të rregullt dhe brenda afateve ligjore pranë AK, ankuesi mund ti drejtohet me ankesë OSHP-së.

Si përfundim kjo ankesë është në kundërshtim me nenin 108/A dhe 109 të Ligjit për Prokurim Publik, dhe nenit 60 të Rregullores 001/2022 për Prokurim Publik, dhe si e tillë hedhet si e pa lejuar dhe nuk hynë në shqyrtim nga OSHP.

Autoritetit kontraktues – Ministria e Punëve të Brendshme, mund të vazhdoj më tutje me aktivitetin e prokurimit (e përshkruar me sipër) nëse nuk ka ankesë tjetër për këtë aktivitet. Organi Shqyrtues i Prokurimit i vë në dijeni se në çdo aktivitet AK duhet të veproj konform dispozitave dhe autorizimeve ligjore siç përcaktohen ato me nenin 1, 6, 7, 27, 28, 59, 60, 65 të LPP-së.

Lidhur me tarifën ankimore vendoset në përputhje me nenin 31 pika 4, të Rregullores së Punës së OSHP-së, që operatorit ekonomik ankues ti kthehet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Kryetarja e OSHP-së, duke u bazuar në atë që u tha si më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vjosa Gradinaj
Kryetare e OSHP-së

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa. Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të parashtroj padi në Gjykatën Komerciale - Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditëve pas pranimit të këtij vendimi

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME**
- OE - **"DataProgNet" SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: